



Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc
dhe Medvegjë

Informacionet rreth aktiviteteve të Shërbimit të Trupit Koordinues

(janar – dhjetor 2014)

Shërbimi i Trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë paraqet raportin rreth aktiviteteve vjetore të realizuara në vitin 2014. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë shënuar këto të arritura dhe rezultate më të rëndësishme:

a) Në fushën e infrastrukturës dhe ekonomisë – Në projektet infrastrukturore në të tri komunat, Shërbimi i Trupit Koordinues në vitin 2014, ka investuar 213.666.443,56 dinarë.

Në komunën e Preshevës janë investuar gjithsej 102.572.840,00 dinarë, për fazën përfundimtare të ndërtimit maternitetit, ndërtimit të çerdhes për fëmijë dhe stacionit shëndetësorë në fshatin Rincë, ndërtimin e terrenit sportiv në fshatin Leran. Në shkollën fillore „Abdulla Krashnica“, është ndërruar zdruktaria, në shkollën e mesme teknike janë ri-konstruktuar salla e edukatës fizike dhe nyjet sanitare. Në Miratoc është ndërtuar rrethoja e oborrit të çerdhes për fëmijë dhe është rregulluar oborri i Shtëpisë së Kulturës në Preshevë. Prej shumës së përgjithshme të lartëpërmendur, 81.500.000,00 dinarë janë investuar në ri-konstruktimin dhe asfaltimin e rrugëve në fshatrat Geraj, Leran, Corroticë, Bukuroc, Rincë, Rahovicë, Norçë, Cakanoc, Sllavujevcë dhe në riparimin e kanalizimit në komunën e Preshevës.

Në infrastrukturën e komunës së Bujanocit janë investuar 78.569.323,56 dinarë. Me këto mjete ka filluar ri-konstruktimi i sheshit të qytetit dhe është vazhduar asfaltimi i rrugës së Vardarit. Është mbështetur edhe mbarësimi artificial i lopëve.

Në infrastrukturën e komunës së Medvegjës janë investuar 32.524.280,00 dinarë në sanimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe të lagjeve, pastrimin e rrugëve, shembjeve dhe rrëshqitjeve, ndërtimin e mbrojtësve të pendave, ndërtimin e kanalizimeve. Është mbaruar projekti për ndriçimin e rrugëve në shumë lokacione, projekti kryesor i administratës komunale, projekti i kanalizimit atmosferik në vendbanimin Nikolla Teslla, projekti i sistemit të ujërave të zeza në Novo Naselë, projekti i ndërtimit të qendrës së Medvegjës dhe projekti për ndërtimin e murit mbështetës. Është renovuar xhamia, është ndërtuar terreni për shtegun e ushtrimeve dhe është rregulluar hapësira përpara SHF „Gornja Jabllanica“. Në tri lokacionet në Medvegjë është vendosur ndriçimi rrugor.

Për qëllim të rimëkëmbjes ekonomike dhe inkurajimin e zhvillimit ekonomik janë përcaktuar 60 milionë dinarë mjete të pakthyeshme për ndërmarrësit e tri komunave.

Rimëkëmbja e kompanive të cilët kanë qenë bartës të zhvillimit ekonomik në të tri komunat është e rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë në jugun e Serbisë. Gjatë vitit 2014, Shërbimi i Trupit Koordinues ka qenë i përkushtuar në realizimin e aktiviteteve të rimëkëmbjes së kompanisë shoqërore „Gumoplastika“, qendër e dikurshme të zhvillimit ekonomik në Bujanoc.

b) Në fushën e integritimeve – Shërbimi i Trupit Koordinues me ndihmën e ambasadës së Britanisë së Madhe ka organizuar ciklusin e dytë falas të „Shkollës së gjuhës serbe për të rinjtë e komunitetit shqiptar nga komuna e Bujanocit dhe Preshevës“. Janë organizuar orët shtesë të gjuhës serbe për nxënësit e klasave të larta të shkollës fillore „Desanka Maksimoviq“, në fshatin Bilaç (komuna e Bujanocit).

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik, ndërsa me ndihmën e ambasadës së Britanisë së Madhe dhe Zyrës së Komesares së Lartë për Pakica Kombëtare, Shërbimi i Trupit Koordinues ka inicuar dhe bërë në mënyrë të përgjithësuar „Studimin mbi mundësitë e avansimit të mësimdhënies dhe mësimin të gjuhës serbe si gjuhë jo-amtare në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë“. Në bazë të rekomandimeve të përmbajtura në Studim, kanë filluar hapat e parë në planin e avansimit të orëve të gjuhës serbe si gjuhë jo-amtare në shkollat fillore në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe.

Në zyrat e Shërbimit të Trupit Koordinues në Beograd, praktikantët nga komuniteti shqiptar arrijnë njohuri të rëndësishme dhe njoftohen me punën e organit të administratës shtetërore. Duke i'u faleminderuar „Programit për praktikë për pjesëtarët e rinj të pakicave në institucionet e Republikës së Serbisë“, tre praktikantë të cilët në ciklusin e kaluar kanë kryer me sukses programin, punojnë në zyrat e Shërbimit Koordinues në Preshevë, Bujanoc dhe Beograd. Përveç dy praktikantëve të rinj, në zyrën në Beograd momentalisht janë të angazhuar në punë edhe dy persona nga komuniteti shqipar.

c) Në fushën e politikës – Në këtë periudhë është mbajtur komunikim i rregullt me përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe institucioneve të Republikës së Serbisë, vetqeverisjeve lokale, Këshillit Nacional të Shqiptarëve dhe akterëve tjerë për qëllim të zgjidhjes së çështjeve më të rëndësishme politike.

d) Në fushën e arsimit – Për 950 nxënës të klasave të para nga të tri komunat janë siguruar çantat shkollore dhe paisjet shkollore për çka dhe janë përcaktuar 1.910.151,70 dinarë.

Me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik dhe në bashkëpunim me Këshillin Nacional të Shqiptarëve janë siguruar 88 tekste dhe fletore pune për nxënësit e shkollave fillore të cilët mësimin e ndjekin në gjuhën shqipe dhe tri libra për nxënësit e arsimit parashkollor. Në bazë të konkursit të Shërbimit të Trupit Koordinues në të tri komunat janë ndarë 309 bursa për nxënësit e shkollave të mesme.

Shërbimi i Trupit Koordinues jep bursa studimi për gjeneratën e katërt me rradhë të të rinjëve nga Bujanoci dhe Presheva të cilët studiojnë në fakultetet e Universitetit të Novi Sadit. Numri i përgjithshëm i bursistëve të cilët studiojnë në fakultetet e Universitetit të Novi Sadit është 35.



Gjenerata e katërt është regjistruar në paralelen e Fakultetit Ekonomik të Suboticës në Bujanoc. Për nevojat e ndërtimit të ndërtesës së paraleles së Fakultetit Ekonomik janë siguruar mjetet e donatorëve nga programi Progresi European, ndërsa Shërbimi i Trupit Koordinues prej buxhetit për vitin 2015, ka përcaktuar mjete për këtë qëllim.

e) Në fushat e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale – Është kryer faza e dytë e ndërtimit të maternitetit në Preshevë dhe janë siguruar paisjet të cilat janë të nevojshme për punën e këtij institucioni. Me këtë Shërbimi i Trupit Koordinues në plotshmëri ka plotësuar të gjitha detyrimet kur bëhet fjala për ri-konstruktimin dhe pajisimin e maternitetit. Progresi European ka siguruar paisjet më të reja.

f) Në mardhëniet ndërkombëtare – Shërbimi i Trupit Koordinues ka krijuar bashkëpunim të jashtëzakonshëm me partnerët ndërkombëtar: Delegacionin e Unionit European në Republikën e Serbisë, ambasadën e Britanisë së Madhe, ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Zyrën e Komesares së Lartë për Pakica Kombëtare, Misionin e OSBE-së në Serbi, USAID-in, programin e Progresit European, me ambasadat dhe programet të cilat mbështesin zhvillimin e jugut të Serbisë. Janë organizuar takime të shumta me partnerët ndërkombëtarë. Kryetari i Trupit Koordinues, profesor Zoran Stanković është takuar edhe me Zherar Shtudmanin, përfaqësuesin special të kryetarit të OSBE-së për Ballkanin Perëndimor.

g) Në komunikim me publikun – Shërbimi i Trupit Koordinues njofton vazhdimisht publikun rreth punës së tij duke shpallur raporte dhe tekste në ueb faqen (www.kt.gov.rs), dërgon raporte mbi punën Qeverisë së Republikës së Serbisë, mediave dhe partnerëve ndërkombëtar dhe organizon konferenca për gazetarë.

Aktivitetet e Trupit Koordinues në vitin 2014, janë të paraqitura në mënyrë kronologjike:

- **Këshilli i Palëve të Interesuara** – Me propozim të Zyrës së Komesares së Lartë për Pakica Kombëtare, në tetor të vitit 2013, është formuar *Këshilli i Palëve të Interesuara*, detyrë e të cilit është të jap rekomandime për qëllim të avansimit të kualitetit të arsimimit në paralelen e Fakultetit Ekonomik në Bujanoc. Këtë trup e përbëjnë përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik, Trupi Koordinues, Fakulteti Ekonomik i Suboticës, komuna e Bujanocit, Këshilli Nacional i Shqiptarëve, Zyra e Komesares së Lartë për Pakica Kombëtare, Delegacioni i Unionit European në Republikën e Serbisë dhe Misioni i OSBE-së në Serbi. Zhvillimi i kualitetit të lartë të mësimin në paralelen e Fakultetit Ekonomik në Bujanoc është njëri ndër prioritetet i të gjithë akterëve të përfshirë në procesin e krijimit të kushteve për promovimin e arsimimit të lartë në jugun e Serbisë.

Janë mbajtur dy takime në vitin 2014, njëri në Bujanoc në janar dhe tjetri në Beograd në tetor. Në të dyjat takimet është treguar gadishmëria e të gjithëve të cilët janë të përfshirë në procesin që të sigurohen kushtet e nevojshme për punë të papengushme të paraleles në Bujanoc dhe studim kualitativ për studentët, para së gjithash për sigurimin e ndërtesës së paraleles së Fakultetit Ekonomik në Bujanoc. Në takimin e janarit është prezentuar *Studimi i Fizibilitetit* në të cilin janë treguar drejtimit e mëtutjeshme të zhvillimit të nevojshëm të këtij institucioni të lartë arsimor dhe potencialet e punësimit të studentëve të diplomuar. Studimin e ka përpiluar Progresi European në bashkëpunim me të gjithë partnerët të përfshira në proces për sigurimin e kushteve për zhvillim të mëtutjeshëm të paraleles së Fakultetit Ekonomik në Bujanoc.

- **Tribuna Serbia në drejtim të Unionit European** – Në janar në Shtëpinë e Kulturës „Vuk Karaxhiq“, në Bujanoc, është mbajtur tribuna *Serbia në drejtim të Unionit European*. Kjo është tribuna e parë mbi temën e integritimeve europiane të Republikës së Serbisë, hapave të bërë në këtë drejtim dhe çështjeve kryesore të cilat janë të nevojshme që të zgjidhen për qëllim të anëtarimit në familjen e vendeve të UE-së, tribunë e cila është organizuar në qëllim të informimit të qytetarëve të kësaj komune, para së gjithash të të rinjëve dhe studentëve të paraleles së Fakultetit Ekonomik,



Rreth kësaj teme kanë folur kryetari i Trupit Koordinues, profesor Zoran Stanković, shefi i Delegacionit të Unionit European në Republikën e Serbisë, Majkëll Devenport, drejtoresha e Zyrës

për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicave, Suzana Paunović, zëdhënsi i drejtorit të Zyrës për Integritet Europian, Sërgjan Majstorović, kryeshefi i administratës policore kufitare të Republikës së Serbisë dhe kryetari i Komisionit për monitorim të regjimit pa viza, Nenad Banović, kryetari i komunës së Bujanocit, Nagip Arifi, kryetari i Këshillit Nacional të Shqiptarëve, Galip Beqiri dhe drejtori i OJQ Forumi Rinor për Edukim të Romëve, Kenan Rashitović.

- **Është bërë pajisimi i maternitetit në Preshevë** – Projekti më i rëndësishëm nga fusha e



dhe Qeverisë së Zvicrrës.

shëndetësisë është ndërtimi i maternitetit në Preshevë. Faza e parë në punët ndërtimore të maternitetit është kryer në fund të vitit 2012, ndërsa një vit më vonë është kryer edhe faza e dytë e ndërtimit. Me fillimin e vitit 2014, materniteti ka fituar paisjet më moderne të nevojshme për punë. Inkubatorët, aparatet e ultrazërit dhe paisjet tjera medicinale janë siguruar përmes programit të EU Progresit, por edhe nga donacionet e Unionit European

- **Shkolla e gjuhës serbe për të rinjtë nga komuniteti shqiptar** – Shërbimi i Trupit Koordinues me ndihmën e ambasadës së Britanisë së Madhe, ka organizuar për herë të dytë shkollën shtatë mujore pa pagesë *Shkollën e gjuhës serbe për të rinjtë të komuniteti shqiptar nga komuna e Preshevës dhe Bujanocit*. Orët në *Shkollën e gjuhës serbe* janë organizuar nga tetori i vitit 2013, deri në maj të vitit 2014. Për të gjithë ndjekësit janë siguruar libra pa pagesë për mësimin e gjuhës. Mësimi është organizuar dy herë në javë, gjatë vikendeve në Bujanoc dhe Preshevë. Tri profesoret e gjuhës serbe kanë punuar me përkushtim në inkurajimin e aftësive gjuhësore, në të cilën punë i kanë ndihmuar asistentët lokal nga komuniteti shqiptar.



Kandidatët e Shkollës së gjuhës serbe në përgjithësi janë nxënësit e shkollave të mesme, mirëpo është parë edhe numër i madh i studentëve të paraleles së Fakultetit Ekonomik në Bujanoc, fakulteteve tjera dhe atyrvë që kanë kryer shkollimin. Edhe këtë vit numri i kandidatëve të interesuar ka kaluar pritshmëritë fillestare. Për *Shkollën* janë paraqitur 260 kandidatë, ndërsa 187 prej tyre kanë kaluar testin përfundimtar dhe kanë marrë diploma të Qendrës Edukative, shkollës së gjuhëve të Novi Sadit, e cila ishte zgjedhur në tender për organizimin e orëve. Me propozim të arsimtarëve të shkollës „Desanka

Maksimović“, në fshatin Bilaç të komunës së Bujanocit, prej janarit e deri në prill Shërbimi i Trupit Koordinues ka organizuar edhe orët shtesë të gjuhës serbe për nxënësit e klasave të larta (prej klasës pestë deri në klasën e tetë). Me këtë edhe njëherë është vërtetuar dëshira dhe gadishmëria e të rinjëve të komunitetit shqiptar për mësimin e gjuhës serbe, mirëpo edhe mbështetja e arsimtarëve dhe prindërve të tyre në nxitjen e aftësive të nevojshme.

- **Është mbajtur mbledhja e Kryesisë së Trupit Koordinues** – Në Beograd është mbajtur mbledhja e kryesisë së Trupit Koordinues në të cilën përveç kryetarit të Trupit Koordinues kanë marrë pjesë edhe kryetarët e tri komunave të Preshevës dhe kryetarët e kuvendeve komunale.

Mbledhja është mbajtur në prani të partnerëve të bashkësisë ndërkombëtare. Me këtë rast është miratuar raporti mbi punën për vitin e ardhshëm i këtij orani të Qeverisë dhe janë ndarë mjetet për nevojat e projekteve infrastrukturore në tri komunat, të cilat janë siguruar në buxhetin e Shërbimit.

- **Është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit** – Kryetari i komunës së Bujanocit, Nagip Arifi dhe dekani i Fakultetit Ekonomik në Suboticë, Nenad Vunjak, kanë nënshkruar Marrëveshjen e Mirëkuptimit në lidhje me funksionimin e qëndrueshëm të Fakultetit Ekonomik të Suboticës, të Universitetit të Novi Sadit - paralelja në Bujanoc. Në ceremoninë e nënshkrimit kanë marrë pjesë kryetari i Trupit Koordinues, Zoran Stanković, ministri i arsimit, Tomislav Jovanović, shefi i Delegacionit të Unionit European, Majkëll Devenport, shefi i Misionit të OSBE-së në Serbi, Peter Burkhard dhe drejtori i Zxrsë së KB për Shërbime Projektuese (UNOPS), Grem Tyndall.



Me nënshkrimin e Marrëveshjes është bërë hap i rëndësishëm në sigurimin e kushteve për studim kualitativ në paralelen e Fakultetit Ekonomik në Bujanoc. Me këtë të rinjët nga ky territor, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, do të mund të arrijnë arsimim të lartë, të planifikojnë të ardhmen në vendin e tyre dhe t'i zhvillojnë potencialet.

Në bazë të Marrëveshjes, kryetari i komunës së Bujanoci Nagip Arifi dhe dekani i Fakultetit Ekonomik në Suboticë, Nenad Vunjak, kanë nënshkruar Kontratën e qirasë pa konpenzim, me të cilën janë rregulluar të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë në lidhje me ndërtesën e paraleles në Bujanoc, ndërtim i të cilës është planifikuar.

Projektin i ndërtimit të ndërtesës së paraleles së Fakultetit Ekonomik të Suboticës në Bujanoc e kanë marrë përsipër këta partnerë Qeveria e Republikës së Serbisë, Unioni European përmes programit të Progresit European dhe komuna e Bujanocit.

- **Studimin mbi mundësitë e avansimit të mësimdhënies dhe mësimin të gjuhës serbe si gjuhë jo-amtare në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë** – Shërbimi i Trupit Koordinues ka inicuar përpilimin e *Studimit mbi mundësitë e avansimit të mësimdhënies dhe mësimin të gjuhës serbe si gjuhë jo-amtare në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë*. Ky dokument është i rëndësishëm së veçantë është përpiluar në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik dhe bashkëpunimin e gjithë akterëve të nivelit lokal dhe nacional të cilët merren me arsim dhe çështjen e mësimin të gjuhës serbe si gjuhë jo-amtare.

Hapi i parë në zhvillimin e dokumentit ka nënkuptuar vizitën e 16 shkollave fillore në tri komunat në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën serbe. Janë mbledhur të dhënat të cilat kanë qenë bazë për konstatimin e modeleve më të mira për mësimin e gjuhës. Në secilën shkollë nxënësit e klasës së katërt dhe të tetë kanë kryer testet me të cilat janë vërtetuar njohurit e gjuhës. Janë bërë anketa me nxënësit, me drejtorët e shkollave, mësuesit dhe arsimtarët janë bërë intervista, ndërsa me prindërit nga këshilli shkollor janë bërë fokus grupet.

Gjatë punës në terren janë intervistuar kryetarët e tri komunave dhe kryetari i Këshillit Nacional Kombëtar, deputeti popullor, këshilltari arsimor i ministrisë përkatëse, përfaqësuesit e sektorit shtetëror dhe ekonomik, administratave komunale, mediave dhe sektorit joqeveritar.

Në konsideratë janë marrë edhe përvojat e projektit *Shkolla e gjuhës serbe* të Shërbimit të Trupit Koordinues dhe projektit të Misionit të OSBE-së *Avansimi i aftësive gjuhësore të banorëve pakicë në jugun e Serbisë*.



Komesares së Lartë për Pakica Kombëtare.

Në bazë të hulumtimeve janë krijuar rekomandimet për avansimin e kualitetit të mësimit të gjuhës serbe. Për nevojat e vërtetimit të drejtimeve hulumtuese dhe analizës primare të rezultateve, për këtë arsye janë formuar grupe punuese të cilat i kanë përbërë të gjithë akterët të cilët merren me arsimim në nivelin lokal dhe nacional. Studimi është rezultat i partneritetit gjithëpërfshirës i të gjitha palëve të interesuara për avansimin e mësimit të gjuhës zyrtare. Përpilimin e studimit e kanë mbështetur ambasada e Britanisë së Madhe dhe Zyra e

- **Bursat për studim në Novi Sad** – Për të katërtin vit Shërbimi i Trupit Koordinues jep bursa të rinjëve nga tri komunat, të cilët dëshirojnë të studiojnë në fakultetet e Universitetit të Novi Sadit. Me këtë program inkurajohen të rinjtë nga jugu i Serbisë që në vendin e vet të arrijnë arsimim të lartë. Prej 41 të paraqiturëve janë zgjedhur 14 kandidatë të cilët kanë marrë bursë për studim. Të përzgjedhurit kanë dhënë provimet pranuese dhe janë bërë studentë të Fakultetit Filozofik, Mjekësisë, Metematiko-natyror, Drejtësisë dhe Bujqësisë. Bursat e Shërbimit të Trupit Koordinues i marrin 35 studentë nga tri komunat.
- **Gjenerata e katërt e praktikantëve është trajnuar në institucionet shtetërore** – Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicave ka organizuar ciklusin e katërt të *Programit për praktikë për të rinjtë – pjesëtar të komunitetit pakicë në institucionet shtetërore të Republikës së Serbisë*. Dy praktikante të komunitetit shqiptar nga komuna e Bujanocit dhe Medvegjës, kanë qenë gjashtë muaj pjesë e ekpit të Shërbimit të Trupit Koordinues në Beograd. Me punën gjashtë mujore me mentoren, kanë arritur njohuri të rëndësishme për perfeksionim profesional të ardhshëm dhe zhvillim personal.



- **Është prezentuar Studimi mbi mundësitë e avansimit të mësimdhënies dhe mësimit të gjuhës serbe si gjuhë jo-amtare në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë** – Në fund të gushtit janë paraqitur rezultatet e *Studimit*. Vetëm pesë përqind e nxënësve shqiptar nga tri komuat kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës serbe. Niveli jo i mjaftueshëm i njohurive gjuhësore sjell deri tek lidhja direkte me shanset dukshëm të zvogëluara që

pjesëtarët e komunitetit shqiptar t'i shfrytëzojnë mundësitë që kanë të bëjnë me arsimin, paraqitjen në konkurset për punë dhe në masë të madhe të jenë pjesëmarrës në proceset vendimarrëse.

Në prezantimin e *Studimit* kanë marrë pjesë kryetari i Trupit Koordinues, profesor dr Zoran Stanković, ministri i arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik, Sërgjan Verbiq, komesarja e

lartë për pakica kombëtare, Astrit Tors, shefi i Delagacionit të Unionit European në Republikën e Serbisë, Majkëll Devenport, ambasadori i Britanisë së Madhe, Denis Kif, kryetari i Këshillit Nacional të Shqiptarëve, Galip Beqiri, deputetët popullor Riza Halimi dhe Shaip Kamberi, ndërsa në emër të të tri komunave të pranishme i`u drejtua kryetari i komunës së Bujanocit, Nagip Arifi.

- **Paisjet falas shkollore për nxënësit e shkollave fillore** – Shërbimi i Trupit Koordinues për pesë vite rradhazi siguron çanta dhe paisje shkollore për nxënësit e klasave të para nga tri komunat. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Tenkologjik, Sërgjan Verbiq dhe kryetari i Trupit Koordinues, profesor Zoran Stanković, kanë ndarë tekste dhe çanta falas me paisje shkollore nxënësve të klasave të para në shkollat fillore „Branko Radiçević“ dhe „Naim Frashëri“, në Bujanoc. Shërbimi i Trupit Koordinues për çantat dhe paisjet shkollore ka investuar 1.910.151,70 dinarë.

- **Është shënuar përvjetori i punës së paraleles së Fakultetit Ekonomik të Suboticës në**



Bujanoc – Edhe këtë vit në mënyrë solemne është shënuar regjistrimi i gjeneratës së katërt të studentëve në paralelen e Fakultetit Ekonomik në Bujanoc. Brucoshët i ka përshëndetur kryetari i Trupit Koordinues, dr Zoran Stanković, sekretari shtetëror i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik, Zoran Mashiq, dekani i Fakultetit Ekonomik, Nenad Vunjak, rektori i

Universitetit të Novi Sadit, Miroslav Veskoviq, shefi i Misionit të OSBE-së në Serbi, Peter Burkhard, kryetari i komunës së Bujanocit, Nagip Arifi, prorektori i Universitetit të Tetovës, Arbër Çeliku, kryetari i Këshillit Nacional të Shqiptarëve, Galip Beqiri dhe menaxheri i agjensionit të Kombeve të Bashkuara për Shërbime Projektuese (UNOPS) dhe programit të Progresit European, Grem Tyndall. Puna e këtij institucioni të lartë arsimor edhe njëherë është vërtetuar në këtë ceremoni se është e rëndësishë së jashtëzakonshme për krijimin e prespektivës të të rinjëve, zhvillimin ekonomik të rajonit dhe ndërtimin e besimit të ndërsjellë.

Këtë vit janë regjistruar 82 studentë. Numri i studentëve të cilët studiojnë me finansim nga buxheti i Republikës së Serbisë është 69. Mësimi në paralelen e Fakultetit Ekonomik në Bujanoc është në dy gjuhë, ndërsa mësimdhënësit janë nga Subotica dhe Tetova.

- **Bursat për nxënësit e shkollave të mesme** – Shërbimi i Trupit Koordinues nxënësve të shkollave të mesme nga tri komunat edhe këtë vit ka ndarë bursa me vlerë mujore prej 6.000,00 dinarë për nxënës. Bursat të cilat kanë karakter social, e kanë marrë 309 nxënës dhe atë 224 nga Presheva, 71 nga Bujanoci dhe 14 nga Medvegja.
- **Nishvilli në Bujanoc** – Nishvilli është njëri ndër xhaz festivalet më të njohura dhe të vizituara në rajon, në të cilin marrin pjesë muzicentët e njohur botëror dhe i cili grumbullon publikë nga vende të ndryshme. Këtë vit Fondacioni i Nishvillit në program ka përfshirë edhe projektin *Xhazi – shprehje multikulturore*, i cili ka paraparë punën me muzicentët e rinj nga Bujanoci, Bosilegradi, Leskoci, Nishi, Vlladiçin Hani dhe Vranja.

Në projekt kanë marrë pjesë nëntë të rinj nga komuna e Bujanocit nga komunitetit shqiptar, rom dhe serb. Kandidatët e punëtorive në muajin tetor i'u janë paraqitur publikut në Bujanoc.

Pjesëmarrja në punëtori, përveç hyrjes në botën e xhazit, i'u ka sjellur përvojë, mundësi udhëtimi, shoqërim, ndërsa për disa kjo ka qenë mundësi shtesë që përmes shoqërimit me moshatarët edhe më mirë t'a mësojnë gjuhën serbe.

Aktivitetet në të cilat kanë marrë pjesë të rinjtë nga Bujanoci i ka mbështetur Shërbimi i Trupit Koordinues.

- **Puna në përmirësimin e pozitës së kategorive të rrezikuara sociale të banorëve** – Ministri për punë, punësim dhe për çështje veterane dhe sociale, Aleksandar Vulin dhe kryetari i Trupit Koordinues, dr Zoran Stanković në nëntor kanë qëndruar në Preshevë. Me këtë rast Vulin dhe profesor Stanković kanë vizituar familjen nëntë anëtarsh, e cila është në sistemin për mbrojtje sociale dhe pjesëtarëve të familjes i'u është dorëzuar donacioni i ministrisë.

Ministri Vulin dhe profesor Stanković kanë biseduar me përfaqësuesit e komunës së Preshevës, kryeshefin e rrethit të Pçinjës, drejtorin e Qendrës për Punë Sociale në Preshevë, me drejtorin e Filales së Shërbimit Kombëtar për Punësim në Vranjë dhe drejtorin Filales PIO në Vranjë. Me rastin e qëndrimit në Preshevë, me përfaqësuesit e qeverisjes lokale ka biseduar rreth mënyrave të ofrimit të ndihmave për personat e rrezikuar social, me propozim që të themelohet kuzhina popullore për afro 500 persona, mirëpo edhe nevojës së sigurimit të tretmanit më të mirë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe hapjes së institucionit për persona të moshuar, për të cilin institucion egziston nevojë e madhe.

- **Mjete të pakthyeshme për zhvillimin e ekonomisë në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje** – Shërbimi i Trupit Koordinues edhe këtë vit në buxhet ka përcaktuar mjete prej 60 milionë dinarësh për finansimin e projekteve ekonomike. Me këtë program i'u jepet mbështetja dhe inkurajimi i zhvillimit të subjekteve ekonomike nga kjo pjesë e vendit. Në konkurs janë ndarë gjithsej 49.756.286,30 dinarë për inkurajimin dhe zhvillimin e 20 kompanive nga tri komunat. Në komunën e Preshevës për zhvillimin e pesë kompanive janë ndarë mjete në vlerë prej 11.864.806,00, në komunën



e Bujanocit i'u janë ndarë 34.891.480,30 për zhvillimin e 14 kompanive, ndërsa një kompani nga komuna e Medvegjës ka fituar mjete të pakthyeshme prej 3.000.000,00 dinarë. Ky është viti i tretë që Shërbimi i Trupit Koordinues ndan mjete të pakthyeshme subjekteve ekonomike nga tri komunat. Nga fillimi i realizimit të programit me të cilin është inkurajuar zhvillimi ekonomik dhe punësimi, Shërbimi i Trupit Koordinues ka investuar 149.338.418,10 dinarë, në 57 kompani me qëllim të hapjes së 150 vendeve të punës për periudhën tri vjeçare.

- **Ndërtimi i ndërtesës së paraleles së Fakultetit Ekonomik të Suboticës në Bujanoc** – Projekti i ndërtimit të ndërtesës së paraleles së Fakultetit Ekonomik është njëri ndër qëllimet strategjike të Qeverisë së Republikës së Serbisë në fushën e zhvillimit dhe disponueshmërisë së arsimimit të lartë të të rinjëve nga jugu. Ky është një partneritet gjithëpërfshirës i Qeverisë së Republikës së Serbisë, komunës së Bujanocit, Fakultetit Ekonomik të Suboticës dhe programit të Progresit European.

Me sigurimin e ndërtesës në të cilin studentët e komunitetit shqiptar, rom dhe serb sëbashku do të studiojnë, studentëve të tanishëm dhe të ardhshëm do t'i ofrohet mundësia që të arrijnë arsimim në objektin e pajisur në mënyrë moderne dhe kualitative.

Lokacionin në të cilin është planifikuar ndërtimi i objektit, për të cilat nevoja Shërbimi i Trupit Koordinues ka finansuar projektin urbanistik dhe kryesor, e kanë vizituar kryeatri i Trupit Koordinues, profesor Zoran Stanković, shefi i Delegacionit të Unionit European në Republikën e Serbisë, Majkëll Devenport, kryeatri i komunës së Bujanocit, Nagip Arifi, dekani i Fakultetit Ekonomik, Nenad Vunjak dhe shefi i Misionit të OSBE-së në Serbi, Piter Burkhard.



Me këtë vizitë është lajmëruar fillimi i punëve ndërtimore. Me këtë rast profesor Stanković, ambasadori Davenport, dekani Vunjak dhe kryetari komunës Arifi janë takuar me studentët dhe me t'a kanë biseduar rreth planeve të Unionit European që mbështesin punësimin dhe krijimin e kushteve më të mira për jetën e të rinjëve në këtë pjesë të vendit, si dhe rëndësisë së integritimeve europiane për të rinjtë.

Unioni European përmes programit të Progresit European ka siguruar mjete për ndërtimin e ndërtesës, ndërsa planifikohet që komuna e Bujanocit dhe Qeveria e Serbisë, përmes Shërbimit të Trupit Koordinues të mbështes projektin me mjetet shtesë. Ndërtimi pritet të përfundohet deri në fund të vitit 2015. Studentët e paraleles në Bujanoc kanë mundësinë që të ndjekin mësimin në tri programe studimore të akredituara: marketing, finansa, drejtimi bankar dhe sigurim dhe agro-biznis dhe agro-ekonomi.

Deri më tani me sukses janë regjistruar katër gjenerata, ndërsa gjithsej 302 studentë nga komuniteti shqiptar, serb dhe rom mësimin e ndjekin në gjuhën serbe dhe shqipe.

- **Gjenerat e re e praktikantëve në Beograd** – Zyra e Shërbimit të Trupit Koordinues në Beograd për katër vite rradhazi e mbështet dhe merr pjesë në *Programin për praktikantë të rinj – pjesëtarë të pakicave nacionale në institucionet shtetërore në Serbi*. Nga dhjetori i vitit 2014, deri në fund të majit të vitit 2015, dy praktikantë të komunitetit shqiptar nga komuna e Bujanocit dhe Preshevës, do të punojnë në zyrën e Shërbimit të Trupit Koordinues në Beograd. Për inkurajimin e njohurive të duhura nga fusha e administratës shtetërore në lëmin e këtij organi qeveritar do t'i ndihmoj mentorja. Përveç Shërbimit të Trupit Koordinues, dhjetë praktikantë të komunitetit shqiptar, boshnjak dhe rom do të mbajnë praktikën në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik, Ministrinë e Kulturës dhe Informimit, Grupin për Përfshirje Sociale dhe Zvogëlimin të Varfërisë, Zyrën për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicave, Zyrën për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Projektin e realizon Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicave me ndihmën e ambasadës së Britanisë së Madhe.
- **Grupi punues për avansimin e mësimin të gjuhës serbe si gjuhë jo-amtare** – Në bazë të rekomandimeve të mbështetura në *Studimi mbi mundësitë e avansimit të mësimdhënies dhe mësimin të gjuhës serbe si gjuhë jo-amtare*, Ministrisa e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik ka formuar grupin punues që ka për detyrë implementimin e rekomandimeve të zgjedhura nga ky dokument i vlefshëm strategjik.

Grupin punues e përbëjnë të gjithë akterët të cilët merren me arsim: Ministria e Arsimit, Shërbimi i Trupit Koordinues, Enti për Avansimin e Arsimit dhe Edukimit, Enti për Vlerësimin e Kualitetit të

Arsimit dhe Edukimit, administratave shkollore të Leskocit dhe Vranjës, Këshilli Nacional i Shqiptarëve dhe tri komunat. Në punën e këtij trupi do të marrin pjesë sipas nevojës edhe arsimtarët, përfaqësuesit e shkollave dhe ekspertët e fushave të caktuara. Në cilësinë e vëzhguesit në grupin punues janë të thirrur edhe partnerët nga bashkësia ndërkombëtare të cilën financiarisht e mbështesin implementimin e rekomandimeve të zgjedhura: ambasada e Britanisë së Madhe, Zyra e Komesarës së Lartë për Pakica Kombëtare, programi i EU Progresit. Gjithashtu, Misioni i OSBE-së në Serbi do të marrë pjesë në punën e grupit punues në cilësinë e vëzhguesit.

Takimi i parë është mbajtur në dhjetor, kur është arritur plani i punës për zbatimin e rekomandimeve dhe është miratuar rregullorja e punës për këtë trup. Aktivitetet e para janë të lidhura me sigurimin e teksteve egzistuese për fëmijët prej klasës së pestë deri në klasën e tetë dhe rritjes së kapacitetit të kuadrit arsimor për arsye të organizimit të mirë të orëve dhe punës kualitative me nxënësit.



- **Është shënuar 14 vjetori i punës** – Zoran Stanković, kryetar i Trupit Koordinues, në Bujanoc ka shënuar 14 vjetorin e punës së këtij organi të Qeverisë. Me këtë rast, në zyrat e Trupit Koordinues në Bujanoc është mbajtur konferenca për gazetarë në të cilën ka folur kryetari i Trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje, Zoran Stanković. Kryetari i Trupit Koordinues ka paraqitur të dhënat që Qeveria e Serbisë përmes këtij organi,

për 14 vite në këto tri komuna ka investuar rreth 6,3 miliardë dinarë, ndërsa donatorët ndërkombëtar rreth 35 milion euro. Gjithsej për 14 vite për komunën e Preshevës, nga buxheti shtetëror janë ndarë 1 miliardë e 778 milion dinarë mjete transfere, për komunën e Bujanocit 2 miliardë e 8 milion dinarë, ndërsa për komunën e Medvegjës 1 miliardë. Gjatë fjalimit të kryetarit të Trupit Koordinues rëndësi të veçantë i'u është kushtuar mediave në këto tri komuna. Ai me gazetarët ka biseduar rreth kushteve në të cilat gazetarët punojnë si dhe privatizimit të ardhshëm.

Në vitin e ardhshëm është planifikuar që Trupi Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje më shumë të punoj në fushat e ekonomisë, në sigurimin e investitorëve dhe zvogëlimin e numrit të punëve.

- **Kompenzimi i dëmëve të shkaktuar nga përbytyjet në komunën e Medvegjës** – Në territorin e Medvegjës në gushtin e vitit 2014, kanë ndodhur përbytyjet. Në përputhje me ligjin dhe detyrat e përcaktuara, administrata komunale e komunës së Medvegjës ka formuar komisionin i cili në vend të ngjarjes ka vërtetuar se cilat amvisëri kanë pësuar dëmin dhe shumat e caktuara të dëmit.

Në bazë të vendimit për ndarje të ndihmës financiare, Shërbimi i Trupit Koordinues i ka transferuar komunës së Medvegjës 1.503.600,00 dinarë, për 19 amvisëritë për me qëllim të sanimit e dëmit të pësuar nga përbytyjet.

- **E kaluara e suksesshme dhe aktivitetet e planifikuara për vitin e ardhshëm** – Shërbimi i Trupit Koordinues ka analizuar punën dhe rezultatet e arritura në vitin 2014, si dhe ka përgaditur propozim planin e aktiviteteve për vitin e ardhshëm.

Në vitin 2015, do të fillojnë punët në ndërtimin e ndërtesës së paraleles së Fakultetit Ekonomik të Suboticës në Bujanoc. Shërbimi i Trupit Koordinues do të vazhdojë që të rrisë zhvillim ekonomik të këtyre tri komunave duke i ndarë e mjeteve të pakthyeshme ndërmarrësve. Gjatë vitit 2015, do

të vazhdojmë aktivitetet në fushën e arsimit, pikë sëpari në planin e mësimi të gjuhës serbe si gjuhë jo-amtare, mirëpo edhe në lidhje më inkurajimin e arsimimit të lartë për të rinjët nga tri komunat. Kemi paraparë një seri aktivitetesh në fushën e kulturës.

*Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së
Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë*
Tel: 011 21 20 906
011 21 20 907
Faks: 011 21 20 909
Adresa elektronike: office@kt.gov.rs
Ueb faqja: www.kt.gov.rs